LIGJ
Nr.9651, datë 11.12.2006

PËR RATIFIKIMIN E NDRYSHIMIT NË "MARRËVESHJEN E RISHITJES SË AKSIONEVE TË INSIG SHA-SË NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE, QË VEPRON NË EMËR TË SHTETIT SHQIPTAR DHE KORPORATËS FINANCIARE NDËRKOMBËTARE (IFC) E BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (BERZH)"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet ndryshimi në "Marrëveshjen e rishitjes së aksioneve të INSIG sha-së ndërmjet Ministrisë së Financave, që vepron në emër të shtetit shqiptar dhe Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC) e Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5160, datë 20.12.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

NDRYSHIM NË MARRËVESHJEN E RISHITJES NDËRMJET BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM DHE KORPORATËS NDËRKOMBËTARE FINANCIARE DHE MINISTRISË SË FINANCAVE, QË VEPRON NË EMËR TË SHTETIT SHQIPTAR

Datë, 10 gusht 2006

Ndryshimi në marrëveshjen e rishitjes (këtu "Marrëveshja e ndryshimit"), e datës 10 gusht 2006, ndërmjet Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Korporatës Ndërkombëtare Financiare (IFC) dhe Ministrisë së Financave që vepron në emër të Shtetit Shqiptar në përputhje me ligjin nr.8831, të datës 22 nëntor 2001 mbi pronësinë shtetërore në shoqëritë financiare tregtare me kapital aksionar plotësisht shtetëror, pronar i aksioneve në Institutin e Sigurimeve sh.a. përfaqësuar nga Ministria e Financave (MF).

Ndërsa:

A) më 28 tetor 2003, EBRD, IFC dhe MF (Palët) përfunduan një marrëveshje për blerjen e aksioneve (marrëveshja e blerjes së aksioneve) në pajtim me të cilën MF-ja i shiti EBRD-së aksionet e EBRD-së dhe MF-ja i shiti IFC-së aksionet e IFC-së;

B) në përputhje me termat e Marrëveshjes së blerjes së aksioneve, më 28 tetor 2003, Palët përfunduan një Marrëveshje rishitjeje (Marrëveshja e rishitjes) duke i dhënë EBRD-së dhe IFC-së të drejta të caktuara për të rishitur aksionet e EBRD-së dhe aksionet e IFC-së MF-së, në pajtim me termat dhe kushtet e parashikuara në të; dhe

C) palët dëshirojnë të shtyjnë periudhën e rishitjes së përcaktuar në Marrëveshjen e rishitjes, me qëllim që t'i japin MF-së një periudhë kohe më të gjatë për të identifikuar një

investitor strategjik të pranueshëm për EBRD-në dhe IFC-në dhe, si pasojë e saj, të shtyjë ndodhinë e ngjarjes së daljes që do t'i jepte mundësi EBRD-së dhe IFC-së për të ushtruar të drejtat e tyre përkatëse për t'i rishitur MF-së aksionet e EBRD-së dhe IFC-së.

Tashmë, për këtë arsye, Palët bien dakord si më poshtë:

Seksioni 1. Përkufizime. Të gjitha termat me germa kapitale të përdorura në këtë Marrëveshje ndryshimi dhe që nuk përkufizohen ndryshe në të, nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe, kanë kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e rishitjes dhe Marrëveshjen e blerjes së aksioneve.

Seksioni 2. Ndryshim në Marrëveshjen e rishitjes

Seksioni 2.1 Seksioni 1.1 (Interpretimi) i Marrëveshjes së rishitjes ndryshohet me ndryshimin e termit të përkufizuar më poshtë:

"Periudha e rishitjes" nënkupton periudhën që fillon në datën e transferimit dhe përfundon më 31 dhjetor 2007.

Seksioni 3. Hyrja në fuqi. Pas ratifikimit nga Parlamenti, kjo Marrëveshje ndryshimi hyn në fuqi ditën e pesëmbëdhjetë pas botimit të ligjit përkatës që miraton këtë Marrëveshje ndryshimi në Fletoren Zyrtare. Nëse kjo Marrëveshje ndryshimi nuk hyn në fuqi në përputhje me dispozitat e këtij seksioni 3 deri më 30 nëntor 2006, kjo Marrëveshje ndryshimi konsiderohet e pavlefshme ligjërisht, përveçse kur bihet dakord ndryshe nga të gjitha Palët.

Në dëshmi të kësaj, Palët kanë marrë masa për të nënshkruar këtë Marrëveshje ndryshimi në emrat e tyre përkatës sipas datës së shkruar më sipër.

Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë
Nga: _____
Emri:
Pozicioni:

Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
Nga: _____
Emri:
Pozicioni:

Korporata Ndërkombëtare Financiare
Nga: _____
Emri:
Pozicioni: